



Pranim / Dotezuar Punijens / Prodato Received / Delivered	20 - 02 3	viti god Year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Dr Prot Dr Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix
SKMISHCK	1926/2023	114



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.12/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës- Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.12/2023, të datës 04.01.2023 të ankuesit kundër Vendimit me numër:190/1/22 i datës 24.11.2022 të Shefit të Departamentit të Administratës në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin dhe 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 20.02.2023, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.12/2023 e datës 04.01.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi me numër:190/1/22 i datës 24.11.2022 i Shefit të Departamentit të Administratës në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare.

A r s y e t i m

Ankuesi i cila sipas shkresave të lëndës është kandidat në procedurën e rekrutimit "Zyrtar për bartshmëri të numrave" të shpallur nga Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, fillimisht me datë 24.12.2022 nëpërmjet adresës zyrtare elektronike ankesa.kpmshck@rks-gov.net ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mirëpo i njëjti është sugjeruar që të plotësoj ankesën e parashtruar dhe pas përmirësimeve të bëra, ankesa e ankuesit në Këshill është regjistruar me datë 04.01.2023 dhe është protokolluar me numër 14/2023, kundër Vendimit me numër:190/1/22 i datës 24.11.2022 i Shefit të Departamentit të Administratës.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshilli pretendon se Departamentit të Administratës në

Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, me rastin e refuzimit të aplikacionit të tij, ka zbatuar gabimisht dispozitat a aplikuar ligjore me rastin e vlerësimit të kualifikimeve universitare të ankuesit pasi që nuk e kanë marr për bazë Diplomën e studimeve Master në fushën e shkencave kompjuterik.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare. Ndërsa me datë 24.01.2023, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vendosje meritore, ka administruar këto prova: Ankesën e datës 04.01.2023 parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës; E-mailin e datës 02.01.2023 dërguar nga ankuesi për Këshillin me korrespondencën e bashkangjitur prej dy (2) faqesh me e-mailin e datës 24.12.2022 dhe 27.12.2022; E-mailin e datës 06.01.2023 me korrespondencën e bashkangjitur prej tre (3) faqesh i protokolluar me datë 10.01.2023; Ankesën e ankuesit të datës 19.11.2022 të parashtruar në ARKEP; Konkursin e datës 06.10.2022; Vendimin me numër: 188/1/22 të datës 18.11.2022 të Shefit të Departamentit të Administratës të ARKEP-it; Vendimin me numër:190/1/2022 të datës 24.11.2022 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore; Konkursin e datës 14.02.2022; Listën e ngushtë të datës 23.03.2022 për konkursin me numër Reference: RN00008403; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 13.01.2023; Përgjigjen në kërkesë të datës 24.01.2023 me numër protokoli:772/2023; Vendimin Nr.161/1/22 të datës 25.08.2022 i Kryetarit të Bordit të ARKEP-it; Listën e aplikantëve; Njoftimin e datës 18.11.2022 Shefit të Departamentit të Administratës; E-mailin e datës 18.11.2022 dërguar nga për ankuesin; Aplikacionin e ankuesit të datës 28.10.2022; Diplomën e ankuesit me numër:4 të datës 12.12.2012; Vërtetimin e noterit me shifër LRP.nr.2359/2022; Diplomën e ankuesit me numër:276 të datës 30.11.2006; Vërtetimin e noterit me shifër LRP Nr.12647/2018; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 25.01.2022; Vërtetimin e datës 23.06.2022; Formularin e vlerësimit të rezultateve në punë i datës 29.01.2021; Letër referencën e datës 05.02.2019; Vërtetimin e datës 09.06.2018; Letër rekomandimin e datës 04.11.2016; Letër rekomandimin e datës 23.11.2016; Letër rekomandimin e datës 18.08.2003; Akt emërimit e ankuesit i datës 28.07.2022 me shifër ..Nr.06/2022; Çertifikatën e datës 23.11.2021 me numër:96; Çertifikatën e datës 23.11.2021; Çertifikatën e datës 18.10.2019.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të gjitha shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, SEPSE:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave gjatë shqyrtimit të shkresave të lëndës ka gjetur se Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare me datë 06.10.2022 ka shpallur në konkursin-lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Zyrtar për Bartshmëri të Numrave (RN00010099) "-kategoria profesionale/klasa Profesional 2, ndërsa kriteret e konkursit kanë qenë: *Arsimimi i kërkuar: Diplomë/a të studimeve universitare në fushën e Telekomunikacionit ose Kompjuterizimit (Bachelor, preferuar Master; Përvoja e punës së kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune në lëmin e telekomunikacionit.*

Po ashtu nga administrimi i shkresave të lëndës, gjegjësisht aplikacionit të datës 28.10.2022 është konstatuar fakti se në këtë konkurs ka aplikuar edhe ankuesi, mirëpo të njëjtit në fazën e verifikimit paraprak përmes Vendimit numër:188/1/22 të datës 18.11.2022 të Shefi i Departamentit të Administratës në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare i është refuzuar aplikacioni me arsyetimin se ankuesi nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit. Tutje, ankuesi kundër Vendimi numër:188/1/22 të datës 18.11.2022 ka parashtruar ankesë të brendshme, ndërsa Shefi i Departamentit të Administratës me datë 24.11.2022 ka nxjerrë Vendimin numër:190/1/22 përmes të cilit e ka refuzuar ankesën e ankueses të datës 19.11.2022 duke e lënë në fuqi Vendimin e datës 18.11.2022 për refuzimin e aplikacionit në fazën e verifikimit paraprak, me arsyetimin se ankuesi nuk e ka plotësuar kriterin e konkursit sa i përket fushës së arsimimit pasi që i njëjti është i diplomuar në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike në Universitetin e Prishtinës, ndërsa fusha e kërkuar në konkurs ka qenë diplomë universitare në fushën e Telekomunikacionit ose Kompjuterizimit.

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, ka analizuar dosjen e aplikacionit të ankuesit dhe ka gjetur se i njëjti posedon Diplomën e datës 30.11.2006 me numër:276 përmes të cilës dëshmohet se i njëjti me datë 18.10.2006 ka mbaruar studimet themelore në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike-**Drejtimi i Sistemeve Elektroenergjetike** në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina" dhe po ashtu ankuesi posedon Diplomën me 120 kredi/ETCS të datës 12.12.2012 me numër:4 përmes të cilës dëshmohet se i njëjti me datë 16.07.2012 ka mbaruar studimet Master në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike-**Programi i shkencave kompjuterike** në Universitetin e Prishtinës "Hasan Prishtina".

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji Këshillit ka analizuar dispozitat e Rregullores Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me Shtojcën Nr.1/9: Përshkrimi i përgjithshëm i punës për klasën Profesional 2, ku përcaktohet arsimimi i kërkuar: "*Diplomë/a të studimeve universitare me të paktën 180 kredi/ECTS apo ekuivalente me to*", nga rrjedh se Njësia e Burimeve Njerëzore me rastin e refuzimit të aplikacionit të ankuesit të datës 28.10.2022 ka vepruar në pajtueshmëri me nenin 45 paragrafi 1, 2 dhe 5 të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës të Kosovës ku përcaktohet se: "*1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurrohet. 2 .Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ. 5.Kandidatët, që nuk plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta, nuk kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin. Vendimi për mosplotësimin e kushteve për aplikim, arsyetohet dhe u njoftohet individualisht aplikantëve, jo më vonë se shtatë (7) ditë kalendarike nga data e mbylljes së pranimin të aplikimeve",* pasi që ankuesi nuk i ka plotësuar kriteret e konkursit lidhur me fushën arsimimit ngase në konkursin e datës 06.10.2022 është përcaktuar se diploma e studimeve universitare duhet të jetë në fushën e Telekomunikacionit ose Kompjuterizimit, kurse ankuesi sa i përket studimeve themelore ka qenë i diplomuar në **Drejtimin e Sistemeve Elektroenergjetike** pranë Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, kurse Diploma e datës 12.12.2012 përmes të cilës dëshmohet se i njëjti me datë 16.07.2012 ka mbaruar studimet Master në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike-**Programi i shkencave kompjuterike** përmban vetëm 120 Kredi/ECTS gjegjësisht nuk është program i fushës së njëjtë (*apo vazhdimësi*) me diplomën e studimeve themelore universitare, sikurse nuk plotësohet as kriteri i përcaktuar në Shtojcën Nr.1/9: Përshkrimi i

përgjithshëm i punës për klasën Profesional 2 si pjesë e bashkangjitur e Rregullores Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës i specifikuar si më lartë në arsyetimin e këtij vendimi.

Andaj, nga se u tha si më lartë Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës, analizimit të dispozitave ligjore dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë të bazuara dhe si e tillë ankesa e ankuesit është refuzuar, ndërsa Vendimin numër:190/1/22 i nxjerrë me datë 24.11.2022 nga Shefi i Departamentit të Administratës në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike është vendim i ligjshëm ngase është nxjerrë mbi bazën e dispozitave të ligjit material, gjegjësisht dispozitave të Rregullores Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës të Kosovës, mirëpo në të ardhmen Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike me rastin e shpalljes së konkurseve duhet të jetë më specifik në përcaktimin e kriterëve sikurse sqarohet edhe me Rregulloren Nr.26/2020 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil të Kosovës lidhur me Shtojcën Nr.1/9:Përshkrimi i përgjithshëm i punës, me qëllim që tek kandidatët të mos krijoj paqartësi procedurale rreth përmbushjes së kriterëve të konkursit.

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1 si dhe nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.12/2023

Flakron GASHI

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI BAJRAKTARI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Bordit në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.